

VENDIM
Nr.54, datë 29.5.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BIOPOWER
GREEN ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa “a”, dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, dhe neneve 18 pika 3, dhe 19 pika 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.5.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (Park eolik BPGE1 dhe BPGE2, Balldren, Lezhë),

dhe konstatoi:

- paraqitjen, konform përcaktimeve të rregullores së procedurave të licencimit, të dokumentacionit dhe deklaratave të kërkuara nga ERE kur dokumentacioni mungon,
- parku BPGE1 përputhet me zonën e studiuar nga shoqëria ERS-08 sh.p.k. për të cilën kanë filluar procedurat e licencimit me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.29, datë 4.3.2008,
- për sa konstatoi më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike. (Park eolik BPGE2, Balldren, Lezhë).

2. Të pezullojë procedurat e shqyrtimit të aplikimit të paraqitur nga shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (Park eolik BPGE1) deri në marrjen konform rregullores së procedurave të licencimit, të vendimit përfundimtar nga Bordi i Komisionerëve për aplikimin për licencim të shoqërisë ERS-08 sh.p.k.

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta